

SHENIMET SPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2.

Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte te percaktuara ne SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55. Rradha e dhenies se shpjegimeve duhet te jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji 25/2018 dt 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2; 49)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1, 35)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1; 37 - 69)

a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.

b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.

c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.

d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.

f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
- Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat

kontabel

- Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e pare , dalje e pare.(SKK 4: 15)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivitetit per periudhen e investimit.(SKK 5: 16)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; 21)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5: 38) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit

mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

	- Per ndertesat ne menyre lineare me	5%	ne vite
	- Kompjuterat e sisteme informacioni		
me		25%	Te vleres se mbetur
	- Te gjitha AAM te tjera me	15%	Te vleres se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5: 59) njesia ekonomike raportuese ka

percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare ndersa normen e amortizimit me 0 % ne vit.